BIDAT A ÇFARË?
PËRKUJTIMI I LINDJES
SË RESULULLAHUT (A.S.)!

20 VJET
NGA NUMRI I PARË
I GAZETËS "UDHA ISLAME"

HISTORIA E PËRGJITHSHME E
MEVLUDIT
DHE TE SHQIPTARËT

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 20 - Nr. 10 (236), Tetor, 2022

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

20 Vjet
Udha Islame
Tetor 2002 - 2022

"Në duart tuaja edhe gazeta *Udha Islame...!*"

"Ja, një lajm i gëzueshëm për besimtarët myslimanë të Shkodrës e më tej! Sot atyre u shtohet edhe një fener tjetër drite për t'u ndriçuar mendjen e zemrën e tyre në rrugën drejt paqes e qetësisë shpirtërore në këtëjetë plot me halle e shqetësime, si edhe një udhëzues i mësimeve të përkryera të Kur'anit, me të cilat fitohen mirësitë e jetës pas varrit.

Ky mjet ndriçues është gazeta "Udha Islame", që pason simotrat e saj të hershme e të vona: "Zani i Naltë", "Kultura Islame", "Njeriu", "Drita Islame", "Triumfi Islam", "Rinia Islame", "Shkëlqimi Islam", "Drita e Dijes" e shumë botime të tjera të kësaj fushe..."

(Fragment nga numri i parë i gazetës Udha Islame, tetor -2002 | Rexhep - 1423)

IMAMI I QABES DRITËSON SHKODRËN NË VIZITËN E TIJ HISTORIKE

(f. 7)

MYFTIU PRITI NË NJË TAKIM TË PËRZEMËRT PRESIDENTIN E REPUBLIKËS, SHTZ. BAJRAM BEGAJ

(f. 15)

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

BIDAT A ÇFARË?
PËRKUJTIMI I LINDJES SË RESULULLAHUT (A.S.)!

Allahun e Madhëruar e falënderojmë për mirësinë e udhëzimit në Islam, salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot, në këtë ditë dhe në çdo moment të jetës sonë, ma të mirit e ma të shtrenjtit të krijesave të Allahut, Hz. Muhammedit (a.s.), me lindjen e të cilit bota e mbarë, gjithësia u rrethua me një mirësi të madhe, shpresë dhe mëshirë nga Zoti i gjithësisë.

Sa herë që vit pas viti e përkujtojmë lindjen e Pejgamberit tonë (a.s.), veçse i tërheqim vëmendjen njëri-tjetrit drejtë hakut të madh të Pejgamberit (a.s.) në veten tonë, dhe i përkujtojmë njëri-tjetrit madhështinë e Pejgamberit (a.s.), jo për ta lidhur këtë thjeshtë me një ditë përkujtimore, por për t'u bërë kjo ditë e begatë e kësaj pranvere të parë një stacion kujtese për gjithsecilin nga ne. Për të mos u ndarë as një ditë dhe asnjë moment nga dashuria dhe lidhja me Pejgamberin (a.s.), për t'u bërë çdo ditë nga ditët e jetës sonë 12 Rebiul-evvel, si dhe për t'u bërë çdo ditë dhe çdo moment atmosferë e begatë e Mevludit Sherif.

Të dashur dhe të shtrenjtë vëllezër dhe motra besimtarë!

Në suren Ali Imran, në ajetin 164, Allahu i Madhëruar na tregon për dashurinë e Tij të madhe dhe për mëshirën e Tij të pakufishme për gjithsecilin nga ne, në rrallë të parë për ata njerëz, tek të cilët u dërgua Pejgamberi (a.s.) 15 shekuj më parë. Urdhëron dhe thotë: "Allahu i bëri një dhuratë të madhe besimtarëve, kur nga mesi i tyre dërgoi të dërguar (Hz. Pejgamberin a.s.), që atyre t'ua lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kuranin dhe urtësinë, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të madhe!".

Allahu (xh.sh.) e përcaktoi ardhjen në jetë të Pejgamberit (a.s.) dhe dërgesën e tij si një dhuratë të madhe për besimtarët. Prandaj ndalu pak dhe pyete veten, a je ti falënderues ndaj Zotit tënd që ta bëri këtë dhuratë të madhe dhe, sa i lidhur je ti pas kësaj mirësie të papërshkruar, që është më e madhja dhuratë që mund të ekzistojë, më e madhja dhuratë, që Zoti ka begatuar me të njerëzinë?!.

Ndalu pak sa, dhe pyete veten: Unë si besimtar në marrëdhënie me Pejgamberin tim (a.s.), që Zoti i Gjithësisë e cilëson si *dhuratë*, si i kam marrëdhëniet, si i kam punët me Pejgamberin tim (a.s.) në përditshmërinë time? Apo jemi mohues të kësaj dhurate të madhe? Apo jemi mohues të kësaj mirësie të madhe dhe e kemi hak me u thanë për ne: "... të pakët janë robërit e Mi falënderues!".

Cili është thelbi i falënderimit në marrëdhënien tonë me Allahun (xh.sh.), për faktin që na e dha këtë dhuratë të madhe, që është Pejgamberi (a.s.)?

Sekreti dhe thelbi i këtij falënderimi është të jesh korrekt me Pejgamberi tonë! Të shkojmë pas dritës së tij, pas udhëzimit të tij, të mos merremi me fjalë sipërfaqësore dhe debate qesharake që e mbajnë ymetin islam të fjetur dhe të përgjumur, dhe që e mbajnë peng të mendësive provinciale dhe të mendësive, që nuk arrijnë të lartësohen për të marrë thelbin e kësaj dhurate, për të ecur me të, për të përparuar dhe për ta përhapur atë gjithandej në jetë.

Çfarë kuptimi ka të shprehim dhe të themi se e duam Pejgamberin (s.a.), mirëpo ne nuk dimë të komunikojmë me njëri-tjetrin?

Çfarë kuptimi ka të shprehim dashurinë e Pejgamberit (a.s.) me fjalë dhe të dëshmojmë me veprat tona arrogancën, mendjemadhësinë, *mos të themi 'injorancën' se është shumë e rëndë*, mungesën e kulturës, mungesën e qytetarisë në komunikim me njëri-tjetrin, brenda familjes tonë të madhe islame?!

Të dashur besimtarë!

Është momenti që në këtë ditë të madhërueshme, në këtë stinë të madhërueshme dhe në këtë prag të madhërueshëm të bëjmë teube (pendim të sinqertë) si dhe të kthehemi hak me zemër nga Pejgamberi (a.s.) dhe t'i themi Zotit: Allahume, unë të kërkoj falje se me të vërtetë kam qenë në hutim!

Ky Pejgamber (a.s.), për të cilin u mallëngjye guri dhe druri, ky Pejgamber i madhëruar nga Zoti i gjithësisë, i cili çdo gjë në këtë univers u lidh me emrin e tij dhe dashurinë e tij, dhe për dashurinë e tij këndoi çdo gjë në univers. I kënduan sahabët dashurisë së tij, i thurën vargje dhe lavde në prani të tij, u gëzua me dashurinë dhe përmallimin e tyre në prani dhe në mungesë.

Ky Pejgamber (a.s.), i cili mbante hytben e tij mbështetur mbi degën e një hurme, kur i ndërtuan një minber më të mirë dhe u largua nga minberi i vjetër, të gjithë në xhami dëgjuan mallëngjimin dhe rënkimin e degës së hurmës. Hz. Ebu Hurejra thotë në hadithin e transmetuar në librat e saktë se: "Të gjithë në xhami e dëgjuan rënkimin e degës së hurmës deri tek personi i fundit në xhami". Pejgamberi (a.s.) ulet nga minberi i tij, e ndalon ligjërimin e tij dhe shkon edhe përqafon atë degë dhe thotë: "Po të mos e kisha afruar nga vetja ime do të vazhdonte kështu deri në ditën e kiametit!".

Ejani të kthehemi me zemër nga dashuria e Pejgamberit (a.s.), jo për një ditë, e jo për një stinë, jo për fjalën Mevlud, e pa fjalën Mevlud. Ejani të mos humbim kohën pas atyre, që janë zhytur në letrat e hutimit dhe debatit shterpë, pas të cilit nuk ka asnjë rreze shprese, drite, dielli, asnjë rreze përkushtimi, përparimi, e zhvillimi. Ejani të kthehemi nga dashuria e Pejgamberit (a.s.) dhe ta vendosim veten në peshoren e dashurisë së gurit e të drurit, që kishin për Zotërinë e bijve të Ademit.

Prandaj, pyete veten; a ka ndopak dashuri dhe përmallim në zemrën tënde për Pejgamberin (a.s.) dhe, krahasohu me degën e hurmës?! Ejani të lartësohemi në gradën e degës së hurmës, se po të afrohemi deri në gjysmën e asaj dashurie që kishte një degë për Pejgamberin (a.s.), patjetër që do të bëhemi më të mirët e shoqërisë sonë dhe përtej saj!

Ai zotëri (a.s) për të cilin transmeton Imam Muslimi, se kur ngjitej në shpellën Hira, një gur i jepte selam. Thotë: "E njoh një gurë në Meke që më jepte selam kur kaloja pranë tij dhe më thoshte; *Paqja e Zotit qoftë mbi ty o Muhammed*". Ishin ditët e para kur Pejgamberi (a.s) shkonte në Hira dhe dëgjonte një selam që i jepej pas shpine; sillte kokën por nuk shihte askënd, përsëri dëgjonte e sillte kokën, nuk shihte askënd! Pastaj thotë: *U ndala dhe e kuptova se ishte një gur dhe e njoh atë gur, i cili më jepte selam në ditët e para në prag të shpalljes dhe dërgesës profetike*".

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Transmeton Imam Ahmedi në Musnedin e tij nga Hz. Ali ibn Ebi Talib, i cili thotë: "Dola një ditë, duke e shoqëruar Pejgamberin (a.s.) në kryerjen e ca nevojave të tij. Nuk kaluam pranë çdo pemë dhe guri veç se tha: Es-selamu alejkum ja Resulullah *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ty, o i Dërguar i Allahut)*". Ky është Pejgamberi, të cilin e ka dashur gjithësia! Ky Pejgamber i madh, i cili erdhi *mëshirë* për njeriun, për kafshën, për natyrën, për gjithësinë, për muslimanin, për femohuesin e për çdo krijesë prej krijesave të Allahut (xh. sh.).

Ky është më i miri i gjithësisë, për të cilin jemi të urdhëruar nga Zoti i gjithësisë, për të shkuar pas dritës së tij të dashur, si dhe për të shkuar pas dashurisë së tij. Larg asaj dashurie dhe dere nuk ka hajr njeriu në këtë botë! Nuk i pranohet askujt në botë, edhe nëse e adhuron Allahun për mijëra e mijëra vite me rrallë, edhe nëse e adhuron Zotin e gjithësisë për mijëra e mijëra vite pa ndërprerje, por nuk ka kaluar nga pragu i dashurisë së Hz. Muhammed Mustafasë (a.s), ai do të shumëzohet me zero dhe është i refuzuar!

"Unë jam zotëria i bijve të Ademit në ditën e kiametit, pa mburrje. Në dorën time është flamuri i falënderimit, pa mburrje. Nuk ka profet atë ditë, Ademi dhe të tjerë, përveçse janë në flamurin tim. Dhe unë jam i pari, të cilit do t'i çahet toka, pa mburrje..!"

Është transmetuar në hadithin e saktë tek Imam Hakimi e të tjerë, se Hz. Ademi (a.s.) iu lut Allahut pasi bëri gabimin, i tha: "Më fal, pash hatrin e Muhammedit!, - Allahu e pyet: Ku e di ti se kush është Muhammedi?, -Ja Rab, e pashë emrin e tij, bri emrit Tënd, tek shtyllat e Arshit dhe tek gjethet e pemëve të xhenetit dhe thashë me siguri nuk është një emër i zakonshëm! Dhe Allahu e fali".

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Është momenti dhe koha që të kuptojmë dhe të dëshmojmë me mendje dhe me zemër se i gjithë universi është i lidhur pas dashurisë së Hz. Muhammedit (a.s.) dhe është shumë e rëndësishme ta pyesim veten, po unë? Po ti? Ndërkohë që Allahu (xh.sh.) urdhëron në Kur'anin Famëlartë: "Thuaj: Nëse me të vërtetë e doni Allahun, më pasoni dhe më ndiqni mua, që t'ju dojë Allahu!".

Dera drejt garancisë së dashurisë së Allahut ka një emër dhe, ai është Muhammed (a.s.); Zotëria i bijve të Ademit, i cili thoshte për veten e tij: "Unë jam zotëria i bijve të Ademit në ditën e kiametit, pa mburrje. Në dorën time është flamuri i falënderimit, pa mburrje. Nuk ka profet atë ditë, Ademi dhe të tjerë, përveçse janë në flamurin tim. Dhe unë jam i pari, të cilit do t'i çahet toka, pa mburrje..!"

Ejani të kthehemi me zemër nga dashuria e Pejgamberit (a.s.), jo për një ditë, e jo për një stinë, jo për fjalën *Mevlud*, e pa fjalën *Mevlud*. Ejani të mos humbim kohën pas atyre, që janë zhytur në detrat e hutimit dhe debatit shterpë, pas të cilit nuk ka asnjë rreze shprese, drite, dielli, asnjë rreze përkushtimi, përparimi, e zhvillimi!

Ejani të kthehemi nga dashuria e Pejgamberit (a.s.) dhe ta vendosim veten në peshoren e dashurisë së gurit e të drurit, që kishin për Zotërinë e bijve të Ademit.

Allahu na bëftë nga ata, që rrugëtojnë drejt dashurisë së Tij dhe afrohen tek Allahu (xh.sh.) nëpërmjet dashurisë për Pejgamberin e Tij (a.s.)!

Diktoi: **Siditë Hafizi**

TIRANA, METROPOLI I VENDIT TIM..!

"

Tirana. Gati-gati, asnjëherë s'më ka tërhequr. Sot, gati-gati, e mendoj ndryshe. Gjithsesi, ajo ngelet metropol. Metropoli i vendit tim.

Metropol evropian? Jo që jo! Metropolet evropiane kanë tjetër sharm, tjetër erë, tjetër zhvillim e tjetër prekje. Metropolet evropiane kanë gjurmë tradite e dritë aveniri.

Metropol lindor? Patjetër që jo! E, sërish, jo! Metropolet lindore kanë tjetër nur. Kanë zhvillim e gjurmë shekujsh, ndryshe. Kanë kulturë e dinamikë të papërshkruar. Kanë...

Tirana është metropol. Ndoshta unik në llojin e vet. Ndoshta.., apo.., kushedi. Metropoli i vendit tim përherë në tranzicion..!

"

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Tiranë, 20 tetor 2022

HISTORIA E PËRGJITHSHME E MEVLUDIT DHE TE SHQIPTARËT

Mr. Ragmi Destani,
Kryetar i KBI - Bujanoc

Mevludi është: 'Historia e lindjes dhe biografia e Muhamedit (a.s) e thurur në vargje'. Kjo formë e manifestimit e cila bëhet në ditët e sotme nuk ishte e njohur në kohën e Muhamedit (a.s), e as në kohën e sahabëve e as në kohën e tabiinëve (tri gjeneratat e para të Islamit), por ka shenja të tjera që Muhamedi (a.s) e kishte kujtuar atë ditë me agjërim dhe forma të tjera.

Për herë të parë manifestimin për ditëlindjen e Muhamedit (a.s) e kishin bërë udhëheqësit e Dinastisë së Fatimitëve në Kajro të Egjiptit në vitin 362 hixhri (në shekullin 4 hixhri). Por kjo formë nuk gjeti shumë përkrahje në botën islame, sepse në formën e manifestimit të tyre gjendej shumë elementi Shiit.

Ndërsa për herë të parë në mënyrë zyrtare, me përkrahje dhe organizim institucional u festua në qytetin Erbil të Irakut nga sundimtari i famshëm dhe shumë bujar si dhe humanisti i madh i asaj kohe Mudhaffer Kevkeburi, kah fundi i shekullit të gjashtë hixhri. Ai në mënyrë madhështore dhe me pjesëmarrjen e dijetarëve dhe prijësve të asaj kohe e organizon manifestimin e ditëlindjes së Muhamedit (a.s). Ai këtë e bëri vetëm atëherë pasi që dijetarët e asaj kohe e lejuan dhe e konstatuan se nuk është në kundërshtim me normat dhe parimet fetare.

Ky manifestim përmbante: ligjërata, fjalime rreth jetës së Muhamedit (a.s), shpërndante ushqim për pjesëmarrësit, jepte sadaka dhe ushqim për të varfrit, i shtonin veprat e mira, etj.. Kjo mënyrë e manifestimit u përhap shumë shpejt në të gjitha vendet islame, si në: Egjipt, Mekë, Azi, Afrikë, në Spanjën muslimane, pastaj në Indi, Turqi, etj. Kjo nënkupton se tradita e manifestimit të ditëlindjes së Muhamedit (a.s) daton rreth 1000 vite në forma jozyrtare, kurse rreth 700 vjet në mënyrë zyrtare dhe me organizime me përkujdesje institucionale shtetërore islame.

Prej asaj kohe e deri në ditët e sotme, Ditëlindjen e Muhamedit (a.s) e feston thuajse tërë bota islame, dhe organizohet në mënyrë zyrtare nga institucionet kompetente fetare ose ministritë e fesë në shtetet islame. Kurse te turqit, Dita e Mevludit për herë të parë u festua në periudhën e sulltan Muratit të tretë (1574-1595 e.r).

Kah fundi i shekullit 15, për jetën dhe veprat e Muhamedit (a.s) gjatë historisë u shkruan shumë vepra, proza, poezi, etj. Vepra më e njohur në poezi kushtuar Muhamedit (a.s) është poezia 'Kasidetul Burde' nga Imam El-Busejri në shekullin e shtatë hixhri (14 e.r) e që përmban 182 vargje, në Egjipt. Pas kësaj e deri në ditët e sotme për Muhamedin (a.s) u shkruan shumë tekste si: prozë, poezi, kaside, monologje e shumë të ngjashme'. Edhe vetë Muhamedi (a.s) në kohën e tij e donte poezinë, e pëlqente kur poetët e lavdëronin atë dhe e mbronin Islamin me poezitë e tyre nga sulmet e idhujtarëve, dhe i inkurajonte të tjerët për poezi.

Muhamedi (a.s) kishte poetin e tij personal, Hasan ibn Thabit, i cili e mbronte Muhamedin (a.s), Islamin dhe muslimanët nga sulmet e poetëve idhujtarë. Kur emigroi në Medine, ai u prit nga medinasit dhe mekasit e shpërngulur me këngën (kasiden) 'Taleal bedru alejna', e që ne e radhisim si ilahi. Është i njohur rasti i 'Kasidetul-Burde' me poetin Ka'ab ibnu Zuhejr, të cilit Muhamedit (a.s) i dhuroi xhyben e tij për lavdërimin që ia bëri me poezi. Muhamedi (a.s) thotë për poezinë: "Poezia është një gjë që të bukurën e bën më të bukur dhe të keqen e bën më të keqe".

Meqenëse ky manifestim i Mevludit nuk ishte i njohur në kohën e Muhamedit (a.s), e as në kohën e sahabëve, e as në kohën e gjeneratës së tretë pas Pejgamberit (a.s), dijetarët islamë, sikur për çdo çështje që shfaqej me kohën, debatuan për zgjidhjen e çështjeve ku zbatuan metodologji shkencore që risinë (bidatin) e paraqitur ta vendosin mbi bazat e përgjithshme në harmoni me parimet e sheriatit. Vetëm atëherë konstatohej se risia ishte çështje e ligjësuar dhe legjitime, ku njëkohësisht konsiderohej adhurim dhe afrim tek Allahu (xh.sh). Ashtu pra bënë edhe për *ditëlindjen e Muhamedit (a.s)* dhe dhanë mendimet e tyre duke krijuar edhe anën ligjore fetare për këtë manifestim.

Gjatë historisë islame, dijetarët për çështjen e Mevludit, u ndanë në tri grupe:

1. *Ata që nuk e lejojnë Mevludin*. Në këtë grup është Muhamed ibn Abdulvehab nga Arabia Saudite dhe bashkëmendimtarët e tij.

2. *Ata që e lejuan Mevludin me disa vërejtje*. Në këtë grup është edhe dijetari Ibn Tejmije, i cili e lavdëron Mevludin dhe tubimin ku lexohet Kur'ani dhe ku bëhet duá.

3. *Shumica dërmuese e dijetarëve islamë të të gjitha kohërave që thonë se manifestimi për ditëlindjen e Muhamedit (a.s) është jo vetëm i lejuar, por edhe i preferuar (Mustehab).* Të gjithë këta dijetarë që lejuan manifestimin e ditëlindjes së Muhamedit (a.s) si diçka e re në Islam, bidatin e ndanë në dy grupe (dy lloje): *Bidat i mirë* dhe *bidat i keq*. *Kurse Mevludin e radhitën nga bidatet e mira*.

ARGUMENTET E DIJETARËVE QË E LEJUAN MANIFESTIMIN E MEVLUDIT

Të gjithë këta dijetarë që e lejuan manifestimin e Mevludit e argumentuan me argumente direkte dhe indirekte nga: Kur'ani, hadithi, ixhmai (konsensusi i dijetarëve) dhe kijasi (analogjia).

1- Argumenti i parë:

Ata, bidatin (risinë), gjërat që janë paraqitur pas vdekjes së Muhamedit (a.s) e ndanë në risi të mirë dhe risi të keqe (risi të pëlqyera dhe risi të papëlqyera). **Imam Shafiu thotë: Bidati është dy lloje: bidat i lavdëruar dhe bidat i urrejtur.** Ai bidat që përputhet me sunetin e Muhamedit (a.s) është i lavdëruar, ndërsa ai bidat që kundërshtohet me sunetin është bidat i papranuar. Mu për këtë, Imam Shafiu mendon se ajo vepër që ka bazë në burimet e sheriatit nuk mund të konsiderohet e ndaluar edhe nëse atë nuk e ka zbatuar Muhamedi (a.s) dhe as'habët e tij.

Dr. Muhamed Said Ramadan El-Buti, një dijetar bashkëkohor, ka thënë për hadithin e Muhamedit (a.s): "... Çdo bidat është (dalalet) humbje)", se te dijetarët e Usuli Fikhut komentohet për çdo veprim që klasifikohet si bidat e që është në esencën e fesë apo shtyllat bazë të fesë.

Veprimet e tilla, si *mevludi e të tjera, konsiderohen si mjete ndihmëse legjitime, për të realizuar interesin e përgjithshëm fetar dhe jetësor*, prandaj, edhe në bazë të hadithit të Pejgamberit (a.s), konsiderohen si rrugë të mira dhe të dobishme, për të cilat Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush hap një rrugë të mirë në Islam, ai ka shpërblimin e tij për këtë rrugë si dhe shpërblimin e atyre që pasojnë të veprojnë në këtë rrugë, pa iu pakësuar shpërblimi ..." - (transmeton Muslimi). Dijetarët në fjalë, Mevludin e radhitën në këtë përfshirje të hadithit, sepse askush nga besimtarët islamë deri më sot, Mevludin nuk e trajtoi si çështje esenciale të besimit, apo si pjesë përbërëse të shtyllave islame.

2- Argumenti i dytë:

Manifestimi i Lindjes së Muhamedit (a.s) është falënderimi i Zotit për ngjarje të rëndësishme dhe për ditë të veçuara. Dijetari Ibn Haxher El-Askalani këtë e argumenton me hadithin e agjërimit të ditës së Ashurës, ku në shenjë falënderimi ndaj Zotit për shpëtimin e Pejgamberit Musa (a.s), Muhamedi (a.s) e përkujtoi këtë ditë me agjërim dhe porositi besimtarët që të agjërojnë.

3- Argumenti i tretë:

Imam Sujuti argumenton se Muhamedi (a.s) kishte prerë kurban (akika) për vetën e tij (për lindjen e tij) pas pejgamberllëkut, edhe pse gjyshi i tij kishte therë për të në ditën e shtatë të lindjes së tij.

4- Argumenti i katërt:

Duke pasur parasysh se Mevludi në formën si organizohet sot, ka filluar në shekullin e shtatë hixhri, pra, një zbatim mbi shtatë shekuj (e në të janë bashkuar tërë ymeti musliman me gjithë dijetarët e tyre) del qartë argumenti për lejimin e tij. Muhamedi (a.s) ka thënë: "Ymeti im nuk bashkohet (unifikohet) në çështje të humbura". Prandaj, do të ishte jo korrekte dhe jo islame dhe aq më pak jo racionale, që të akuzohen dijetarët e shtatë shekujve bashkë me popujt e tyre për veprime jo islame dhe veprime të ndaluara sipas dispozitave islame.

5- Argumenti i pestë:

Të gjithë muslimanët (gati), në krye të tyre dijetarët islamë janë të mendimit se festimi i Mevludit është vepër e mirë. Muhamedi (a.s) thotë: "Ajo që muslimanët e mendojnë për të mirë, tek Allahu është e mirë".

6- Argumenti i gjashtë:

Besimtarët për Mevludin gëzohen dhe shfaqin dashurinë për Muhamedin (a.s) e në anën tjetër dashuria ndaj Muhamedit (a.s) dhe gëzimi për të, është kusht i vlefshmërisë së imanit.

7- Argumenti i shatë:

Muhamedi (a.s) e veçoi ditën e hënë nga ditët e tjera, ku ai kishte traditë të agjëronte këtë ditë. I pyetur për arsyen e agjërimit të kësaj dite, ai u përgjigj: *"Kjo është dita kur unë linda, dhe dita kur u gradova si i dërguar"*. Dhe ky duket argument mjaft i fortë dhe i qartë për festimin e ditës së lindjes së tij.

8- Argumenti i tetë:

Dita e lindjes dhe dita e vdekjes përmendet edhe në Kur'an. Allahu në Kur'an në lidhje me pejgamberin Isa (a.s) thotë: "Dhe Paqja qoftë për të, në ditën kur lindi dhe ditën kur do të vdesë". Gjithashtu përsëritjen e këtij teksti e bënë edhe vetë pejgamberi Isa (a.s) duke thënë: "Dhe paqja qoftë për mua, në ditën kur linda dhe në ditën kur do të vdes". Në këto dy ajete gjejmë argumente të forta mbi respektimin e ditës së lindjes dhe të vdekjes.

9- Argumenti i nëntë:

Këto tubime llogariten mexhlise të hajrit, të dhikrit, të përmendjes së Zotit, të salavateve mbi pejgamberin Muhamed (a.s), etj..! Kurse Muhamedi (a.s) na ka porositur me hadith që të pushojmë në këto mexhlise kur të gjendemi aty.

10- Argumenti i dhjetë:

Manifestimi i mevludit nëse nuk ka bazë në Kur'an e as në sunet për ta kremtuar, ai nuk ka bazë as në Kur'an e as në synet se është i ndaluar. Përkundrazi shumica absolute e dijetarëve islamë, me gjithë popujt e tyre, të gjitha kohërave, e kanë

6

5

Pra Mevludi, si dhe disa ceremoni të tjera, kanë qenë i vetmi kontakt për bisedë të lirë mes imamit dhe xhematit të tij. Mulla Jakup Asipi, Allahu e mëshiroftë, thoshte: Jam i gatshëm që çdo rresht të Mevludit t'ua argumentoj me ajet kur'anor ose me hadtih ose me thënie të sahabëve, etj. Nga gjithë sa u tha, bazuar në argumente, konstatohet se manifestimi i mevludit nuk është i obliguar (farz), por është pjesë e traditës dhe kulturës tonë fetare (shpirtërore).

përkrahur, dhe kjo konsiderohet (ixhma) konsensus i dijetarëve islamë. Dhe konsensusi i dijetarëve është burim i ligjit në jurisprudencën islame.

TRADITA E MEVLUDIT TE SHQIPTARËT

Shqiptarët Mevludin e kanë trashëguar nga turqit, të cilët kremtimin e tij e kanë filluar në shekullin 15. Ndërsa tekstin e parë të Mevludit në gjuhën turke e shkroi Imami i Ullu Xhamisë në Bursë, Sulejman Çelebiu në vitin 1405, që ishte bazë e shkrimeve të mevludeve në gjuhën shqipe.

Mevludi te shqiptarët ka filluar të njihet dhe të kremtohet nga shekulli 18 dhe është me ndikim dhe shtrirje sa asnjë manifestim tjetër fetar, dhe më i përhapur si në familje, xhami, vende publike dhe më gjerë. Është i pari që është kuptuar diçka nga feja islame në gjuhën shqipe në mungesë të literaturës tjetër fetare të shkruar. Kurse ndër hoxhallarët shqiptarë më të njohur që shkruan Mevlude ishin: Muhamed Çami, Ismail Floqi, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ali Ulqinaku, Tahir ef. Popva, Hasan Zuko Kamberi, etj! Deri sot, janë shkruar rreth 30 tekste të Mevludit në gjuhën shqipe. Mevludi i parë që u shkrua në gjuhën shqipe ishte ai i Hasan Zuko Kamberit në mesin e shekullit 18. Ndërsa Mevludi më i përhapur në trevat shqiptare është ai i Tahir ef. Popovës.

Dijetarët shqiptarë të fesë islame të të gjitha kohërave gjithashtu edhe institucionet fetare shqiptare gjithmonë e kanë përkrahur dhe e kanë praktikuar kremtimin dhe këndimin e Mevludit.

ROLI DHE NDIKIMI I MEVLUDIT TE SHQIPTARËT.

Sikur te shumë popuj të botës, edhe te shqiptarët, Mevludi organizohej jo vetëm në muajin e Mevludit Rabiul evel, por edhe për raste gëzimi, lindje fëmije, syneti, hyrje në shtëpi të re, fejesa, martesa, bile edhe për ngushëllime në postmortum, etj.

Mevludi te shqiptarët bëhet kështu: *'Pas faljes së namazit fillohet me lexim nga Kur'ani, pastaj salavate mbi Pejgamberin, Muhamedin (a.s), pastaj këndimi i Mevludit i shoqëruar me salavate, shpeshherë në mes lexohet përsëri pjesë nga Kur'ani, përfundimi me Kur'an, dhe në fund lutje'*. Gjatë qëndrimit në këto mexhlise gjithmonë praktikohen këshilla dhe ligjërata fetare, diskutim rreth fesë, përgjigje të pyetjeve te besimtarëve, shtrohet ushqim për të pranishmit, etj.

Këndimi i Mevludit luajti një rol shumë të rëndësishëm në veçanti në kohën e komunizmit, ku ishte ndoshta nga mundësitë e rralla që të takohet imami me xhematin e tij të të gjitha shtresave, sepse në familjet ku këndohej Mevlud tuboheshin, hoxhallarë, xhemati, gra, fëmijë, të rinj, intelektualë, politikanë, etj, ku këta ftoheshin në Mevlud për afërsinë familjare që kishin me të zotin e shtëpisë që bënte mevludin. Kjo llogaritej, por edhe sot llogaritet *metodë e thirrjes në islam*, ku hoxha apo thirrësi në islam duhet t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet e mundshme për të përhapur njohurit të fesë islame, sepse këtë e bënte edhe Muhamedi (a.s) gjatë misionit të tij profetik.

Pra Mevludi, si dhe disa ceremoni të tjera, kanë qenë i vetmi kontakt për bisedë të lirë mes imamit dhe xhematit të tij. Mulla Jakup Asipi, Allahu e mëshiroftë, thoshte: Jam i gatshëm që çdo rresht të Mevludit t'ua argumentoj me ajet kur'anor ose me hadtih ose me thënie të sahabëve, etj. Nga gjithë sa u tha, bazuar në argumente, konstatohet se manifestimi i mevludit nuk është i obliguar (farz), por është pjesë e traditës dhe kulturës tonë fetare (shpirtërore).

Është një mirësi (mustehab) që myslimanët, kudo që janë, dhe sidomos në trojet tona, të shënojnë ditëlindjen e Pejgamberit (a.s), ngase praktika po tregon se, në mungesë të festimeve islame dhe nevojës së begatisë shpirtërore, myslimanët, veçanërisht rinia, po orientohet për kremtime festash krejtësisht të huaja, që nuk kanë asgjë të përbashkët me identitetin e tyre fetar.

(Bazuar në librin: Mevludi tek shqiptarët, përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor, Prishtinë, 22 prill 2009).

Dr. Salahudin Keftaro

Festimi i Mevludit të Pejgamberit (a.s) është i legjitimuar dhe i pëlqyer!

Por, madhështia e ringjalljes së përkujtimit është, të lindë metoda (rruga) e Pejgamberit tek ne dhe të jetë e jashtmja dhe e brendshmja jonë pasqyrë e moralit të tij, përmendjes (dhikrit) të tij, mendimit të tij, xhihadit (sakrificës) së tij, drejtësisë së tij, mëshirës së tij... etj.

Ky është festim, që përcjell shpirtin e Pejgamberit Fisnik.

Sepse, festimi është argument i dashnisë dhe dashnia është argument i pasimit:

"Thuaj: Nëse jeni, që e doni Allahun, atëherë më pasoni muaj, që t'ju dojë Allahu..!" - *(Kur'ani, Ali Imran: 31)*

IMAMI I QABES DRITËSON SHKODRËN NË VIZITËN E TIJ HISTORIKE

Ditën e mërkurë, më 4 tetor 2022, qyteti i Shkodrës u begatua me vizitën historike të imamit të Mesxhidi Haramit, Qabes së Madhnueshme, Shejkh Abdullah El-Xhuheni, që shoqërohej nga kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu dhe delegacioni saudit.

Besimtarët e shumtë që kishin tejmbushur xhaminë e Parrucës, patën mirësinë të përjetonin emocione të shumta, duke falur namazin e akshamit pas Hirësisë së Tij.

Aktiviteti vijoi me ligjëratën dhe mesazhet e imamit të nderuar, që iu drejtua besimtarëve për të qëndruar besnikë të Librit të Allahut dhe Traditave të të Dërguarit të Tij, përkushtimit ndaj fesë dhe ruajtjes së vëllazërisë në mes vete.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe Kryetari i KMSh, H. Bujar Spahiu.

20 VJET NGA NUMRI I PARË I GAZETËS "UDHA ISLAME"

Allahu i Madhëruar na tregon në Kur'anin Famëlartë se, detyrë nuk është vetëm kumtimi i mesazhit, por ky kumtim duhet të jetë në formën më të përsosur. Ai (xh.sh), duke na treguar për rolin e të dërguarve të Tij, thotë: "A nuk është detyrë për të Dërguarit, vetëm se kumtimi i qartë"? - (Nahl: 35)

Lavdrim Hamja
Kryeredaktor - "Udha Islame"

Gazeta Udha Islame, ashtu siç është e shkruar në nëntitullin e saj, është organ mediatik i Myftinisë Shkodër, e përmuajshme, informative, fetare, kulturore dhe edukative, që u themelua dhe nxori numrin e saj të parë në tetor të vitit 2002.

Pas miratimit të Myftiut dhe Këshillit të Myftinisë së asaj kohe dhe KMSh-së, gazeta nisi rrugëtimin e saj me grupin e redaksisë së përbërë nga:

1. Arben Halluni, *kryeredaktori i pare*
2. Faik Luli, *anëtar*
3. Islam Dizdari, *anëtar*
4. Ismail Muçej, *anëtar*
5. Fejzi Zaganjori, *anëtar*
6. Sokol Mandi, *anëtar*
7. Ilir Lugji, *anëtar*

Që nga ajo ditë dhe deri më sot, kjo gazetë ka vazhduar rrugëtimin e saj, jo thjesht për të mbushur një boshllëk në fushën e gazetarisë islame në Shqipëri, duke ditur se është gazeta e vetme e një myftinie në vend, por për të qenë me të vërtetë "Udhë Islame", në të cilën ecin jo vetëm besimtarët, por edhe ata, të cilët duan të mësojnë dhe të informohen rreth Islamit dhe veprimtarive e aktiviteteve të ndryshme, që myslimanët e Shkodrës zhvillojnë në qytet.

Përmbajtja e gazetës, kryesisht mbështetet tek kronikat e aktiviteteve të ndryshme, që zhvillon Myftinia Shkodër, pastaj vijnë rubrikat e vazhdueshme, siç është rubrika e *Hytbeve*, *Mesazheve*, *Fjala e muajit*, *Personalitete botërore islame*, *Bota Islame*, *Lajme*, etj.

Në këtë gazetë janë përcjellë dhe vazhdojnë të përcillen mendimet dhe pikëpamjet e dijetarëve të mëdhenj të Islamit, si: Dr. Jusuf El-Karadavi, Shejkh Muhamed El-Gazali, Shejkh Ahmed Keftaro, Dr. Mustafa Mahmud, Shejkh Vehbi S. Gavoçi, Shejkh Shuajb El-Arnauti, etj.

Në përgjithësi artikujt e botuar në gazetën Udha Islame (qofshin shkrime autoriale apo përkthime) janë autentikë dhe botohen për herë të parë dhe me lejen e autorëve të tyre.

Gazeta "Udha Islame" shërben edhe si dritare e mbrojtjes së çështjeve të ndryshme islame, qytetare, shoqërore etj, përmes reagimeve dhe deklaratave.

Që gazeta të mos mbesë vetëm në Shkodër, ajo shpërndahet me postë tek më shumë se 50-të myftini dhe organizata e institucione të ndryshme islame dhe jo islame, në mbarë Shqipërinë dhe jashtë saj, tek xhamitë e ndryshme shqiptare në botën perëndimore, etj.

Gjithashtu gazeta "Udha Islame" publikohet rregullisht në internet në formatin pdf, ku mund të shkarkohet në çdo kohë prej të interesuarve dhe lexuesve të saj, të cilët nuk kanë mundësi ta marrin të shtypur në letër.

RËNDËSIA E NJË GAZETE ISLAME

Nuk ka dyshim, se teknologjia ka përparuar shumë, veçanërisht ajo e informimit dhe e medias, megjithatë gazetat mbetet një mjet i fortë dhe tepër ndikues në botë.

"Arma më e rrezikshme e shekullit të 20-të. Shpikja Nr. 1, e cila ndryshoi rrjedhjen e historisë është aparati i medies. Fjala është kolegu që formëson mendjet... Lumenj gazetash, të cilat shpërlajnë trurin e lexuesve.

Parullat, afishet dhe sloganet që udhëheqin mitingjet... Televizioni, i cili boshatis mendjet e shikuesve nga përmbajtja e tyre, pastaj kthehet dhe i mbush ato me të reja, me gjithçka të lehtë dhe pa vlerë - kështu do të shprehej Dr. Mustafa Mahmud, në shkrimin e tij: "Prostitucion me fjalën".

Allahu i Madhëruar na tregon në Kur'anin Famëlartë se, detyrë nuk është vetëm kumtimi i mesazhit, por ky kumtim duhet të jenë në formën më të përsosur. Ai (xh.sh), duke na treguar për rolin e të dërguarve të Tij, thotë kështu: "A nuk është detyrë për të Dërguarit, vetëm se kumtimi i qartë"? (Nahl: 35)

Të përhapësh fjalën e Zotit të Madhëruar dhe të përcjellësh mesazhet e të Dërguarit të Allahut (a.s) është detyrë për çdo mysliman në përgjithësi dhe detyrë për çdo institucion islam në veçanti. Sigurisht që kjo detyrë e rëndësishme në shërbim të Islamit duhet të kryhet ashtu siç urdhëron Zoti në Kur'an dhe siç e ka kryer i Dërguari i Tij (a.s).

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: "Thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ta (kundërshtarët) në atë mënyrë që është më e mira...". - (Nahl:125)

Ndërsa i Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Përcillni nga unë, qoftë edhe një fjalë të vetme...". - (Transmetuar nga Buhariu)

Duke u nisur nga këto porosi, kuptojmë se nxjerrje dhe mbajtja e një gazete islame, në rastin konkret, gazeta Udha Islame, është detyre e rëndësishme, të cilën duhet ta kryejmë në mënyrën dhe formën më të mirë.

Ne jemi të vetëdijshëm se, nevoja për këtë gazetë është më e madhe, se sa të dalë vetëm njëherë në muaj, por mundësitë dhe rrethanat janë të tilla, që e kanë kufizuar vetëm me kaq, shto këtu edhe përdorimin e madh tek njerëzit, që kanë marrë rrjetet sociale. Megjithatë, ne ndihmën e Zotit, kjo gazetë do të vazhdojë udhëtimin e saj të Udhës Islame.

FALËNDERIM...

"Kush nuk falënderon njerëzit nuk ka falënderuar Allahun" - ka thënë Pejgamberi (a.s).

Në këtë 20 vjetor të daljes së numrit të parë të gazetës "Udha Islame", duhet të falënderoj nismëtarët e krijimit të gazetës, Myftilerët e nderuar, duke filluar nga i ndjeri H. Faik Hoxha, H. Bashkim Bajraktari, Imam Ndriçim Sulejmani. Ermal Nurja dhe Myftiu aktual, Imam Muhamed Sytari, të cilët mbajtën mbi supe ecurinë dhe vazhdimësinë e kësaj gazete, që nuk ka qenë krejt e lehtë të mbahet, pasi ka pasur vështirësi dhe pengesa jo të pakta për ta ndërprerë daljen e saj apo për ndaluar botimin plotësisht.

Gjithashtu, falënderim të veçantë edhe për bashkëpunëtorët, imamët, thirrësit islamë dhe intelektualët e ndryshëm, të cilët kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontributin e tyre me vlerë në pasurimin e gazetës me mendime, vizione, analiza dhe shtjellime të ndryshme të vyera, duke e bërë atë më tërheqësi për lexuesin dhe duke i shtuar vlerën dhe pozitën e saj.

Secilit prej tyre, Zoti i dhashtë mbarësi dhe sukses në të mirë të shoqërisë dhe mbarë njerëzimit.

PRANË VARRIT TË PEJGAMBERIT (A.S)..!

DR. MUSTAFA MAHMUD

Qëndrova me kokën ulur dhe i turpëruar pranë varrit të të Dërguarit fisnik e fjalët më ishin arratisur...

E gjithë qenia ime e mbushur me turp prej teje, o Resulullah!

Ti e përsose kumtimin prej Zotit tënd, ndërsa ne nuk e bëmë. E përsose këshillimin për ymetin, ndërsa ne nuk morëm këshillë. E mbarte Librin tënd me fuqi, ndërsa ne nuk e mbartëm. Triumfove të vërtetën, ndërsa ne nuk e triumfuam.

Disa prej nesh mjaftuan me mjekrën, duke thënë: Ky është Suneti yt. Të tjerë shkurtuan rrobat dhe thanë: Ky është urdhri yt. Morën të rëndomtën, mashtruan njerëzit, mjaftuan prej fesë me lëvozhgën, mjaftuan prej xhihadit me historinë e tij dhe ndejën e ndejtëm edhe ne me ta.

Njerëzit e ulët, të pa vlerë, çobanë e të devijuar na hipën përmbi shpatulla, na derdhën gjakun, na shitën vendin dhe na përçanë copë-copë.

O ndërmjetësuesi i botëve, shpresa e të dobëtëve dhe e zemërthyerve, na ndërmjetëso për ne te Zoti yt, ndoshta Ai na pranon pendimin dhe kënaqet me ne. Ai na ka premtuar, dhe premtimi i Tij është i vërtetë; nuk ka pendim për ne, veçse prej pranimit të pendimit nga Ai dhe nuk ka kënaqësi, veçse me kënaqësinë e Tij...

Nuk ka portë për ndërmjetësim, përveçse nga porta jote dhe nuk ka afrim, veçse prej bujarisë tënde.

Lutu për ne që nata të mos jetë e gjatë dhe mjerimi të mos na zërë.

Es-selamu alejke, o Muhammed. Salavati i Allahut qoftë mbi ty ditën që linde, ditën që vdiqe dhe ditën që do të ringjallesh!

Es-selamu edhe përmbi fisnikët e devotshëm, zotërinjtë e njerëzimit dhe imamët e dynjasë, Ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin dhe Aliun dhe yjet e tjerë rrezatues prej sahabeve, të cilët jetuan nën hijen e shpatave.

Lutu për ne, ne jemi ushtarët tuaj në Egjipt, për të cilët ke thënë: Ne jemi ushtarët më të mirë të tokës dhe se ne do të jemi të gatshëm deri në Ditën e Kiametit.

Që të jemi te mendimi yt i mirë dhe të jemi vërtetues i profetësisë tënde dhe argument i Mesazhit tënd.

Es-selamu alejke, deri në Ditën e Llogarisë!

Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja

AFGANISTANI
OSE EMIRATI ISLAMIK I AFGANISTANIT

Afganistani, ose zyrtarisht Emirati Islamik i Afganistanit, është një vend që ndodhet aty ku kryqëzohen rrugët e Azisë Qendrore dhe të Azisë Jugore. Ky vend i quajtur edhe si Zemra e Azisë, kufizohet me Pakistanin në lindje dhe në jug, me Iranin në perëndim, me Turkmenistanin në veriperëndim, me Uzbekistanin, Taxhikistanin dhe Kinën në veri. Vendi ka një sipërfaqe prej 652.864 km2, dhe një popullsi prej 40.994.840 banorësh (shtator 2022, sipas worldometers.info).

Kabuli është qyteti më i madh i vendit dhe kryeqyteti i tij.

GJEOGRAFIA

Relievi në Afganistan është i larmishëm, kryesisht malor dhe i thyer, me disa kreshta malore të pazakonta të shoqëruara nga pllaja dhe pellgje lumenjsh. Ai dominohet nga vargmali Hindu Kush, shtrirja perëndimore e Himalajeve. Shumica e pikave më të larta janë në lindje, të përbëra nga lugina malore pjellore, të konsideruara shpesh si pjesë e "Çatisë së Botës". Hindu Kush përfundon në malësitë perëndimore-qendrore, duke krijuar fusha në veri dhe jugperëndim, përkatësisht fushat e Turkestanit dhe pellgun e Sistanit. Këto dy rajone përbëhen nga kullota kodrinore, gjysmë-shkretëtira, dhe shkretëtira me erë të nxehtë. Pyjet gjenden në korridorin midis provincave Nuristan dhe Paktika, kurse Tundra (në të cilin nëntoka është gjithmonë e ngrirë) ndodhet në veri-lindje. Pika më e lartë e vendit është Noshak, me 7.492 metër mbi nivelin e detit. Pika më e ulët shtrihet në provincën Xhouzxhan, përgjatë bregut të lumit Amu Darja, me 258 metër mbi nivelin e detit.

Pavarësisht numrit të madh të lumenjve dhe rezervuarëve që ka vendi, pjesë të mëdha të tij janë të thata. Baseni endorheik (që e ruan ujin) i Sistanit, është një nga rajonet më të thata në botë. Lumi Amu Darja rrjedh në veri të maleve Hindu Kush, ndërsa lumi Hari Rud aty pranë, rrjedh në perëndim drejt Heratit. Lumi Argandab rrjedh nga rajoni qendror, drejt jugut. Lumi Kabul, përbën një përjashtim,pasi rrjedh në drejtimin lindor, drejt luginës Indus, dhe përfundon në Oqeanin Indian.

Në Afganistan bie shumë borë gjatë dimrit, në malet Hindu Kush dhe Pamir, dhe shkrirja e borës në stinën e pranverës furnizon lumenjtë, liqenet dhe përrenjtë, megjithatë, dy të tretat e ujit të vendit derdhen në vendet fqinje,në Iran, Pakistan dhe Turkmenistan. Vargmali verilindor Hindu Kush, që ndodhet brenda dhe rreth provincës Badakhshan të Afganistanit, është në një zonë gjeologjike aktive, ku tërmetet mund të ndodhin atje pothuajse çdo vit.

KLIMA

Afganistani ka një klimë kontinentale. Malësitë qendrore, verilindja e akullnajave (rreth Nuristanit) dhe korridori Vakhan, karakterizohen nga midis dhjetorit dhe prillit. Zonat më të ulëta të Afganistanit verior dhe perëndimor janë më të thatat; reshjet bien kryesisht në lindje. Megjithëse ndodhet afër Indisë, Afganistani është kryesisht jashtë zonës së Musoneve, me përjashtim të provincës së Nuristanit, e cila herë pas here preket nga shirat Musone, në verë.

EKONOMIA

Bujqësia mbetet burimi më i rëndësishëm i punësimit në Afganistan: 60-80 për qind e popullsisë së Afganistanit punon në këtë sektor. Afganistani prodhon rreth 1.5 milion

dimri i ashpër, ku temperatura mesatare në janar shkon në -15 °C, dhe mund të arrijë deri në -26 °C. Kurse zonat e ulëta të pellgut Sistan në jugperëndim, pellgu i Xhelalabadit në lindje dhe fushat e Turkestanit përgjatë lumit Amu Darja në veri, karakterizohen nga vera e nxehtë, me temperatura mesatare mbi 35 °C në korrik, por që mund të arrijnë deri mbi 43 °C.

Vendi në verë është përgjithësisht i thatë, pasi shumica e reshjeve bien ton fruta të freskëta në vit, veçanërisht mollët, kajsitë, qershitë, fiqtë, rrushin, pjeprin, manaferrat e ëmbla, pjeshkat dhe shegët. Ndërtimi dhe përdorimi i serave është një industri me rritje të shpejtë në vend. Sipërfaqja e tokës së punueshme në Afganistan është rreth 8 milion hektarë. Prodhimi i grurit arrin në rreth 5 milionë tonë, fidanishtet zënë 119.000 hektarë tokë dhe prodhimi i rrushit arrin në 615.000 ton. Në vend prodhohen gjithashtu me shumicë edhe bajamet, pambuku, shafrani, etj.

Blegtoria në Afganistan përfshin gjedhin, delet dhe dhitë. Ndërtimi dhe përdorimi i fermave moderne të shpendëve është gjithashtu një industri me rritje të shpejtë atje. Toka e përshtatshme për kullotje, e ka bërë blegtorinë një pjesë të rëndësishme tradicionale të ekonomisë. Ka dy lloje kryesore të blegtorisë: ajo sedentare, që praktikohet nga fermerët që rrisin kafshë dhe kultivojnë të mbjella, dhe ajo endacake, që praktikohet nga barinjtë e bagëtive,dhe që njihen atje si 'kukis'. Kullotat natyrore mbulojnë rreth 7 milion e 500.000 hektarë të sipërfaqes së vendit. Zonat veriore rreth Mazari-Sherif dhe Mejmene,kanë qenë shtëpia e rreth gjashtë milionë deleve karakul, në fund të viteve 1990. Shumica e tufave transferohen në verë në malësitë dhe kullotat në veri.

Afganistani ka shumë pellgje, lumenj dhe përrenj, gjë që e bën atë një mjedis të përshtatshëm për kultivimin e peshkut.

Ndër elementët më të spikatur të pasurisë minerale për të cilën shquhet Afganistani janë bakri (zotëron rezervën e dytë më të madhe në botë, që kap një vlerë prej 88 miliardë dollarësh) dhe hekuri, me rreth 2.2 miliardë tonë.

Ekonomia e Afganistanit është përmirësuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit, për shkak të injektimit të miliarda dollarëve të ardhur në formën e ndihmave ndërkombëtare, dhe nga dërgesat e emigrantëve afganë.

HISTORIA

Eksplorimi arkeologjik i bërë në shekullin e 20-të, beson se zona gjeografike e Afganistanit ka qenë e lidhur ngushtë me kulturë dhe tregti, me fqinjët e saj në lindje, perëndim dhe veri. Në Afganistan janë gjetur objekte tipike të epokave të Paleolitit, Mesolitit, Neolitit, Bronzit dhe Hekurit.

Kryeqyteti, Kabuli

Qytetërimi urban besohet të ketë filluar që në vitin 3000 p.e.s, dhe qyteti i hershëm i Mundigak (afër Kandaharit në jug të vendit) ka qenë qendër e kulturës Helmand. Gjetjet më të fundit vërtetuan se qytetërimi i luginës Indus shtrihej drejt Afganistanit të sotëm, një qytetërim i lashtë që sot i takon të jetë pjesë e Pakistanit, Afganistanit dhe Indisë.

Nga viti 2000 p.e.s, valët e njëpasnjëshme të njerëzve gjysmë nomadë nga Azia Qendrore filluan të vinin në jug të Afganistanit. Në mesin e tyre kishte shumë indo-iranianë që flisnin gjuhën indo-evropiane. Këto fise më vonë migruan nëpërmjet zonës në veri të detit Kaspik, drejt Azisë Jugore, Azisë Perëndimore dhe Evropës. Ky rajon në atë kohë quhej Ariana.

Nga mesi i shekullit të 6-të p.e.s, Akaemenidët përmbysën Medët dhe i përfshinë Arakosinë, Arinë dhe Baktrian brenda kufijve të tyre lindorë.

Aleksandri i Madh dhe forcat e tij maqedonase mbërritën në Afganistan në vitin 330 p.e.s, pasi që një vit më parë kishin mposhtur Dariusin III të Persisë, në Betejën e Gaugamelës. Pas pushtimit të shpejtë që Aleksandri i Madh i bëri vendit, Perandoria Seleukide,e kontrolloi rajonin deri në vitin 305 p.e.s, ku ata ia dhanë pjesën më të madhe të këtij rajoni Perandorisë Maurja, si pjesë e një traktati aleance. Maurjanët kontrolluan zonën në jug të Hindu Kushit derisa u rrëzuan rreth vitit 185 p.e.s. Rënia e tyre filloi 60 vjet pas përfundimit të sundimit të Ashokas, duke çuar në ripushtimin helenistik nga greko-baktrianët. Pjesa më e madhe e asaj zone u shkëput shpejt prej tyre, dhe u bë pjesë e Mbretërisë Indo-Greke.

Gjatë shekullit të parë p.e.s, u shfaq Rruga e Mëndafshit, dhe Afganistani lulëzoi nëpërmjet tregtisë, nëpërmjet rrugëve për në Kinë, Indi, Persi dhe në veri deri në qytetet e Buhara, Samarkand dhe Khiva në Uzbekistanin e sotëm. Në këtë pikë qendrore shkëmbeheshin ide edhe mallra, si mëndafshi kinez, argjendi persian dhe ari romak, ndërsa rajoni i Afganistanit të sotëm nxirrte dhe tregtonte gurë 'lapis lazuli', kryesisht nga rajoni i Badakhshanit.

Gjatë shekullit të parë p.e.s, Perandoria Parthiane e nënshtroi rajonin. Nga mesi deri në fund të

Xhamia Blu, Mazari Sharif

shekullit të parë të erës sonë, perandoria e madhe Kushan, sundoi Afganistan. Kushanët u përmbysën nga Sasanidët, në shekullin e III-të erës sonë. Këta u pasuan nga Kidaritët, të cilët, nga ana tjetër, u zëvendësuan nga Heftalitët. Ata u zëvendësuan nga Shahët turq, në shek.e 7-të, të cilët u zëvendësuan nga një dinasti hindu, përpara se Saffaridët muslimanë të merrnin zonën, në vitin 870.

GJUHA

Dari dhe Pashto janë gjuhët zyrtare të Afganistanit.

Afganët janë të ndarë në disa grupe etnolinguistike, ku Pashtunët janë grupi më i madh etnik, me 39%, të ndjekur nga Taxhikët (ose Farsivanët), që përbëjnë 37% të popullsisë së vendit. Në përgjithësi tre grupet e tjera kryesore etnike janë Taxhikët, Hazarasit dhe Uzbekët.

Pavarësisht se pashtunët kanë qenë dominues në politikën afgane për shekuj, Dari mbeti gjuha e preferuar për qeverinë dhe burokracinë. Ekziston edhe një numër i gjuhëve më të vogla rajonale në vend, si uzbekishte, turkmene, balochi, pashai dhe nuristani. Kur bëhet fjalë për gjuhët e huaja, shumë prej afganëve janë në gjendje të flasin ose të kuptojnë gjuhën hindu (urdu-hindi). Anglishtja kuptohet gjithashtu nga një pjesë e popullsisë, siç njihet edhe rusishtja, e cila u mësua në shkollat publike gjatë viteve 1980.

FEJA

Sipas vlerësimeve të CIA-s të bëra në vitin 2009, thuhet se 99.7% e popullsisë afgane janë myslimanë, ku shumica e tyre ndjekin Shkollën Sunite Hanefi. Pjesa tjetër e popullsisë, 0.3 %, përbëhet nga sikët, hindutë dhe të krishterët.

Sipas kushtetutës së Afganistanit, vendi është një Republikë Islame, ku "asnjë ligj nuk mund të jetë në kundërshtim me fenë e shenjtë të Islamit", ndërsa qeveria, sipas kushtetutës gjithashtu, kërkohet të mbrojë të drejtat e njeriut dhe të garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve.

SI ERDHI ISLAMI NË AFGANISTAN?

Në fund të shekullit të shtatë e.j., Umajedët arabë muslimanë, hynë në Afganistan, pasi mundën Sasanidët, në betejën e Nehavendit. Pas disfatës, perandori sasanid Jezdexhridi i III-të, u arratis në Azinë Qendrore. Muslimanët arabë hynë brenda Afganistanit, derisa arritën në Herat, dhe më pas në Afganistanin lindor, dhe bënë përpjekje të mëdha për përhapjen e Islamit në mesin e popullatës vendase. Shumë banorë në veri të vendit e pranuan Islamin, veçanërisht gjatë sundimit të kalifëve umejadë Hisham ibn Abdul-Melik dhe Omer ibn Abdul-Aziiz. Herë pas here, udhëheqësit myslimanë e inkurajonin popullsinë të konvertohej në Islam, nëpërmjet thirrjes në fe dhe përkthimit të Kuranit nga arabishtja në persisht, në mënyrë që të kuptonin se çfarë thuhej në Libër.

Gjatë kohës së El-Mua'tesim-it, Islami u bë feja e shumicës së popullsisë afgane, veçanërisht gjatë mbretërimit të Jakub Leith Safari, i cili e bëri Islamin fenë dominuese në Kabul dhe në pjesën tjetër të qyteteve të rëndësishme në Afganistan. Samanidët e përhapën Islamin sunit në zemër të Azisë Qendrore, dhe e përkthyen të gjithë Kuranin nga arabishtja në persisht, në shekullin e nëntë të erës sonë. Midis viteve 998 dhe 1030, Mahmud El-Ghaznevi vendosi të dëbonte pasuesit e mbetur të sektit hindu nga kufiri lindor i Afganistanit.

DISA DIJETARË TË LINDUR NË AFGANISTAN, OSE ME PREJARDHJE NGA AFGANISTANI

Nu'man ibn Thabit, i njohur si **Imam Ebu Hanife**, ishte me origjinë nga Afganistani, nga Kabuli. Ai ishte një teolog dhe jurist musliman, dhe themeluesi i Shkollës Hanefi të Jurisprudencës Islame Sunite, e cila ka mbetur shkolla juridike më e praktikuar në traditën sunite, dhe që mbizotëron në Azinë Qendrore, Afganistan, Iran (deri në shekullin e 16-të), Ballkan, Rusi, Çeçeni, Pakistan, Bangladesh, ndër myslimanët e Indisë, në Turqi, dhe në disa pjesë të botës arabe.

Ebu Davud Es-Sixhistani, i njohur me emrin Ebu Davud, ka qenë një dijetar i hadithit profetik, i njohur për veprën e tij: Sunen Ebu Davud.

Muhamed ibn Hibban El-Busti, i njohur is Ibn Hibbani, ka qenë një dijetar musliman, i njohur për veprën e tij në fushën e hadithit profetik: Sahih Ibn Hibban.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://www.worldometers.info
https://www.britannica.com
https://en.wikipedia.org
https://www.marefa.org
https://ar.wikipedia.org
https://www.aljazeera.net



Dr. Selman El-Aude

"Vdekja nuk është kundërshtimi i jetës, por ajo është zgjatim i saj!

Kush jeton në rrugën e Allahut, e denjon të jetë vdekja e tij në rrugën e Allahut, edhe sikur të vdesë në shtratin e tij; siç ka qenë gjendja e Halid ibnul-Velidit (r.a).

Vdekja nuk është proces i shpëtimit të shpejtë prej përgjegjësive të jetës dhe detyrave të saj, siç edhe xhihadi i madh, që është në fushën e jetës me davet (me thirrje), me durim ndaj vështirësive, përballjeve me akuza dhe vazhdimësi e rrugës drejt Allahut, përkundër gjithë këtyre, duke kërkuar udhëzim me fjalën:

"Ihdinas-siratal-mustekim" (Udhëzona në Rrugën e Drejtë!)"

BETEJA E DYTË E KOSOVËS...

OSMANËT ARRIJNË KULMIN E LAVDISË SË TYRE NË VIGJILJE TË ÇLIRIMIT TË KOSTANDINOPOJËS

Beteja e Dytë e Kosovës, e cila u zhvillua në vitin 1448, konsiderohet si kulmi i agresionit hungarez për t'u hakmarrë ndaj disfatës së rëndë, që u shkaktu nga osmanët në Betejën e Varnës në vitin 1444. Megjithatë, ushtria osmane i mundi përsëri Magjarët, duke hapur kështu rrugën për çlirimin e Kostandinopojës në vitin 1453.

Më 17 tetor 1448, një aleancë e ushtrive kryqtare, të udhëhequr nga Mbretëria e Hungarisë dhe Vllahisë, nën drejtimin e John Huniad, komandantit ushtarak hungarez me përvojë dhe rojtarit të fronit të Hungarisë në atë kohë, u përpoqën të hakmerren për disfatën e rëndë që iu shkaktua nga osmanët në betejën e Varnës në vitin 1444, duke i shpallur luftë Perandorisë Osmane. Ky veprim erdhi si përpjekja e fundit e madhe e kryqtarëve për të çliruar Ballkanin nga sundimi osman dhe si përpjekje për të mbështetur Kostandinopojën dhe për të zbutur presionin e osmanëve ndaj saj.

Ushtria trime osmane, nën udhëheqjen e Sulltan Muradit II, qëndroi e palëkundur dhe i shkaktoi një disfatë të rëndë hungarezëve, në një betejë të ashpër që u zhvillua tre ditë rresht në fushën e Kosovës, ashtu siç përfundoi Beteja e Parë e Kosovës në vitin 1389, në të cilën fitorja i takoi osmanëve.

Një nga rezultatet më të rëndësishme të kësaj betee ishte konfirmimi i shtrirjes së kontrollit të Perandorisë Osmane në Ballkan, gjë e cila hapi rrugën për çlirimin e Kostandinopojës pesë vjet më vonë, dhe pikërisht, më 29 maj 1453, kur u çlirua nga djali i Sulltan Muradit II, i riu Sulltan Muhamed Ngadhënjyesi.

OSMANËT PARA PUSHTIMIT

Osmanët gëzonin një trimëri të madhe dhe maturi të rrallë, veçanërisht gjatë shekujve të parë të perandorisë së tyre, tokat e të cilave shtriheshin në tre kontinentet e botës së vjetër. Gjysma e parë e shekullit të 15-të dëshmoi fitore të njëpasnjëshme, që hapën shumë toka romake për osmanët, dhe këto fitore arritën kulmin me çlirimin e Kostandinopojës.

Pasi Sulltan Murati II nënshtroi vendin e Moresë (aktualisht Greqia jugore) në vitin 1446, dhe më pas shkatërrimi i disa kryengritjeve dhe intrigave, që u zhvilluan kundër osmanëve në Evropën juglindore, Sulltani iu drejtua përballjes me Skender Beun, i cili u rebelua kundër sundimit osman, përmes mbështetjes, që i dha Papa Nikolla V dhe e sundimtari i Hungarisë, John Huniadi.

Huniadi mendonte, se i duheshin më shumë se 40.000 luftëtarë për të mposhtur osmanët dhe kërkoi të përfshinte edhe forcat shqiptare të udhëhequra nga rebeli Skënderbeu, i cili tashmë kishte dalë kundër Perandorisë Osmane, për gati 25 vjet.

Në vitin 1448, komandanti i ushtrisë hungareze, Johanna Hunyad, kaloi lumin Danub për të bashkuar forcat e tij me forcat e Skënderbeut, por më 17 tetor të po këtij viti, ushtria e tij u përplas me ushtrinë osmane.

Dy grupet u përballën në Fushë-Kosovë, pasi Huniadi nuk arriti të përcaktonte vendndodhjen e ushtrisë kryesore osmane, sepse besonte se kjo e fundit ishte akoma në Edrene, kryeqyteti osman atëkohë. Por, ushtria osmane kishte përparuar dhe befasoi ushtrinë huniade, duke e zënë në befasi, ku dy ushtritë u ndeshën në një betejë të ashpër, pikërisht në periferi të Prishtinës, kryeqyteti i Kosovës së sotme.

BETEJA MË E ASHPËR NË FILLIM TË EPOKËS OSMANE

Burimet historike e konsiderojnë Betejën e Dytë të Kosovës si një nga luftërat më të ashpra dhe më të përgjakshme të fillimit të epokës osmane, krahasuar me Betejën e Parë të Kosovës, e cila u zhvillua mes dy këtyre ushtrive, nëntë vjet më parë. Përmasat e dy ushtrive u dyfishuan nga beteja e parë. Numri i ushtrisë osmane varionte nga 40 deri në 60 mijë luftëtarë, ndërsa hungarezët kishin një numër nga 24 deri në 30 mijë luftëtarë.

Ditët e para të betejës ishin disi të qeta, ndërkohë që të dy palët ndërtuan mbrojtjen e tyre. Beteja filloi me përplasje të veçanta dhe përleshje midis kalorësisë; në kalorësinë hungareze shpërtheu paniku kur panë pamundësinë e depërtimit në zemër të ushtria osmane, gjë që çoi në arratisjen (largimin) e disa krahëve të ushtrisë hungareze në ditët e para të betejës.

Në ditën e nesërmen, kalorësit osmanë "Sifahiler" mundën bindshëm kalorësit hungarez në një disfatë të tillë, duke i eliminuar plotësisht. Kjo u pasua nga një sulm natën i kryqëzatave, duke përdorur karroca dhe topa kundër pozicionit kryesor të Sulltan Muradit II, në natën e 18/19 tetorit, gjë që rezultoi me shumë gjakderdhje, por pa rezultate vendimtare ushtarake.

Në ditën e tretë dhe të fundit të betejës, pikërisht me 19 tetor 1448, osmanët vranë një numër të madh të ushtrisë kryqtare, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej tyre, mori arratinë.

VENDIMTARJA DHE FITORJA OSMANE

Fitorja e osmanëve në Betejën e Dytë të Kosovës erdhi falë aftësisë së Sulltanit osman, i cili përdori kalorësinë "sefah" për të rrethuar kalorësinë e krahut të majtë të ushtrisë kryqtare. Përveç këtij procesi të rrethimit, ushtria osmane nisi një sulm të përgjithshëm përgjatë vijës së përballjes mes dy ushtrive, në mënyrë që shpërqendronte vëmendjen e Huniadit nga sulmi kryesor.

Manovra pati sukses dhe kalorësit sefah korrën me shpatë të gjithë kalorësit e Vllahisë, Moldavisë dhe Hungarisë. Pjesa tjetër e mbetur e ushtrisë kryqtare u spraps dhe Huniadi u arratis nga beteja, duke parë se ai tashmë kishte humbur.

Beteja e dytë e Kosovës hoqi shpresat e kryqtarëve, se do të mund të parandalonin përparimin e osmanëve drejt Kostandinopojës, pasi mbretëria hungareze nuk kishte më burime ushtarake apo financiare, dhe kështu u hap rruga për Sulltan Mehmetin II (Ngadhënjyesin), i biri i Sulltan Muradit II, për të imponuar një rrethim mbi Kostandinopojën, që do të çlirohej në vitin 1453.

(www.trtarabi.com)

Përshtati në shqip nga arabishtja:
Lavdrim Hamja

MYFTIU I SHKODRËS MORI PJESË NË PËRURIMIN E XHAMISË SHQIPTARE “EBU HANIFE” NË TROISDORF TË GJERMANISË

Me ftesë të Qendrës Islame Kulturore Shqiptare (Bashkësia Islame Shqiptare “Ebu Hanife”), Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në ceremoninë e përurimit të xhamisë së re shqiptare në qytetin Troisdorf të Gjermanisë, që u zhvillua ditën e shtunë, më 1 tetor 2022.

Në një atmosferë të mrekullueshme, në mesin e shumë personaliteteve të shquara islame të trojeve tona shqiptare, imamëve dhe myftilerëve të ardhur nga Zvicra, Gjermania, Belgjika, Maqedonia e Veriut, Kosova e Shqipëria, autoriteteve vendore, përfaqësuesve të kishave të qytetit, besimtarëve të shumtë dhe interesimit të medias, ceremonia në fjalë, u kthye në një festë të madhe, të dëshmuar për organizimin e përsosur në çdo detaj.

Në fjalën e mbajtur para të pranishëmve, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, falënderoi organizatorët dhe krejt kontribuuesit për ngritjen e xhamisë së re shqiptare “Ebu Hanife”, në zemër të Evropës, duke dëshmuar se shqiptarët janë ambasadorë të vlerave islame dhe atyre kombëtare, pararojë e përhapjes së dritës islame, kudo në perëndim, sidomos në tri dekadat e para të këtij shekulli, nëpërmjet ngritjes së qendrave bashkëkohore islame dhe xhamive të reja në shumë shtete evropiane, për frymën e harmonisë, tolerancës dhe respektit njerëzor, si dhe shembullin e mrekullueshëm e largpamës në kultivimin e vlerave tona, kudo e me këdo, pa dallim!

Myftiu Sytari u lut për mbarësi dhe suksese të Xhamisë “Ebu Hanife”, kryesisë dhe imamit të saj, si dhe uroi që ky shembull i bukur të përhapet gjithandej, si një dëshmi e padiskutueshme e besnikërisë tradicionale të shqiptarëve ndaj fesë islame dhe amanetit shekullor të baballarëve.

MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI NË XHAMINË SHQIPTARE “BASHKIMI”, NË NÜRNBERG TË GJERMANISË

Me ftesë të Qendrës Islame Shqiptare/AIG “Bashkimi”, në Nürnberg të Gjermanisë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në aktivitetet me rastin e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s).

Ditën e diel, më 2 tetor 2022, Myftiu i Shkodrës vizitoi grupin e nxënësve që mësojnë pranë xhamisë shqiptare “Bashkimi”, ku dha disa këshilla të vyera për ruajtjen e tabanit islam dhe mësimin e gjuhës shqipe. Poashtu, iu përgjigj edhe pyetjeve dhe bashkëbisedoi me nxënësit për tematika që lidhen me formimin e tyre.

Po atë ditë, Myftiu ligjëroi para xhematit të kësaj xhamie, në përbërje të cilit ka besimtarë shqiptarë me prejardhje nga të gjitha trevat tona kombëtare.

Imam Sytari foli rreth pozitave të rinisë në Islam dhe domosdoshmërisë së leximit drejtë të shembullit të sahabëve të rinj, për ndërtimin e personalitetit të fortë e të qëndrueshëm të djalit të ri dhe vajzës së re në mesin tonë, të mëkuar me moral e dije, me njerzillek e përkushtim ndaj tjetrit, kushdo qoftë.

Në krye të herës, Myftiu falënderoi imamin e xhamisë “Bashkimi” në Nürnberg, H. Sevgani Asani, për ftesën bujare, për mikpritjen dhe përkushtimin.

MYFTIU PRITI NË NJË TAKIM TË PËRZEMËRT PRESIDENTIN E REPUBLIKËS, SHTZ. BAJRAM BEGAJ

Paraditën e së mërkurës, më 5 tetor 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, Presidentin e Republikës, ShTZ. Bajram Begaj, në vizitën e tij të parë zyrtare në qytetin e Shkodrës.

Një bashkëbisedim i ngrohtë me theks tek përhapja e vlerave tona besimore, qytetare e kombëtare, si pjesë e pandarë e tabanit të vlerave të trashëguara nga të parët.

Medreseja “Haxhi Sheh Shamia” dhe rrezatimi i saj në edukimin shkencor, moral e kombëtar, si një garanci për të sotmen dhe të ardhmen e brezave.

Përpjekja e vazhdueshme për të përhapur shpresë në kohët e vështira nëpër të cilat kalon shoqëria shqiptare dhe plagët që shkakton pesimizmi, etj.

Rreth këtyre tematikave dhe të tjerave me interes të përbashkët, u diskutua më këtë pritje të ngrohtë që Myftiu i Zonës Shkodër i rezervoi Presidentit të Republikës.

VEPRIMTARI ARGËTUESE NË REÇ ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË XHAMIVE OBLIKË DHE MURIQAN

Ditën e diel, më 09 tetor 2022, në zonën turistike të Reçit, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër zhvilloi aktivitetin “Mësojmë dhe argëtohemi”, me pjesëmarrjen e rreth 50 nxënësve të mejtepeve/kurseve fetare të xhamive Oblikë dhe Muriqan, nën shoqërimin e mësuesve Kimete Elezi dhe Ajet Sukaj.

Në këtë aktivitet ishte i pranishëm teologu Arben Halluni, drejtuesi i arsimit, i cili pasi i uroi mirëseardhjen nxënësve në këtë veprimtari arsimore-argëtuese të radhës, u mbajti një bisedë të shkurtër me vlera edukative dhe me këshilla mjaft të vlefshme për këtë brez të ri, i cili kërkon një vëmendje të vazhdueshme nga të gjithë aktorët edukues.

Më pas, programi vijoi me zhvillimin e bisedave brenda grupeve, lojëra të ndryshme sportive, shëtitje në natyrë, etj.

Cikli i aktiviteteve “Mësojmë dhe argëtohemi”, do të vijojë me të tjera xhami gjatë periudhës vjeshtë-dimër.

MYFTIU I SHKODRËS FALËNDERON KONTRIBUTET E FONDACIONIT “MIRËNJOHJA”

Paraditën e së mërkurës, më 12 tetor 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune në ambientet e Fondacionit Humanitar “Mirënjohja”, ku u prit nga drejtori i këtij fondacioni, H. Samed Shehu, me bashkëpunëtorë.

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu falënderoi kontributet e Fondacionit “Mirënjohja” në afrimin e donatorëve dhe projekteve me dobi për bashkësinë islame, sidomos në Shkodër, nëpërmjet të cilave u mundësua, veçanërisht, ndërtimi i xhamisë së bukur të lagjes Kiras, mbështetja e shumë familjeve të jetimëve, etj.

U diskutua për vazhdimin e bashkëpunimit në disa drejtime konkrete me interes të përbashkët.

VAZHDOJNË PUNIMET PËR RESTAURIMIN E XHAMISË SË PLUMBIT

Mëngjesin e së hënës, më 17 tetor 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga stafi i Myftinisë Shkodër, zhvilloi një inspektim, për të parë nga afër punimet për restaurimin e Xhamisë së Plumbit.

Myftiu u njoh me disa prej etapave të këtij procesi të rëndësishëm për xhaminë shekullore, ku aktualisht po punohet në disa drejtime, si brenda objektit ashtu dhe në vakëfin përreth tij.

Nga punimet e rregullta, kanë dalë në pah gjurmë të vjetra të punimeve shekullore brenda objektit, disa varre shekullore, ai dhe disa gjurmë të

trashëgimisë islame të kësaj zone.

Myftiu falënderoi drejtuesit e punimeve dhe ekipin e gjerë, që po punojnë në mënyrë intensive për të realizuar në kohë restaurimin e plotë dhe të shumëpritur të xhamisë simbol të rimëkëmbjes së besimit, pas periudhës së diktaturës.

MYFTIU I SHKODRËS: "FONDACIONI 'MIRËSIA', I DËSHMUAR PËR BAMIRËSI DHE KORREKTËSI NDËR VITE!"

Ditën e enjte, më 20 tetor 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë pune në ambientet e Fondacionit "Mirësia", ku u prit nga drejtori, z. Korab Kaja.

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu vlerësoi kontributet e vazhdueshme të Fondacionit "Mirësia" ndër vite, sikurse theksoi se vit pas viti, bashkëpunimi ndërmjet Myftinisë Shkodër dhe Fondacionit "Mirësia" është rritur, duke dëshmuar një përkushtim të madh në drejtim të ndërtimit të xhamive të reja, qendrave kulturore, shtëpive për të pastrehët, përkujdesjes për jetimët, nevojtarët, etj.

Myftiu Sytari dhe z. Kaja diskutuan edhe për format e reja të bashkëpunimit mes Myftinisë Shkodër dhe Fondacionit "Mirësia", me qëllim ardhjen në ndihmë komunitetit dhe dëshmimit të frymës së bamirësisë islame gjithandej.

PËRFUNDOI CIKLI I PROGRAMIT "SI TË JEMI TË QËNDRUESHËM NË BESIM?"

Myftinia Shkodër, për gjatë një muaji organizoi në qendrën kulturore të saj në Zdrale, programin intensiv me tematikë: "Si të jemi të qëndrueshëm në besim?".

Nën drejtimin dhe moderimin e teologes Zamira Bushati, pjesëmarrëset (psikologe, mjeke, dhe intelektuale të lëmive të ndryshme) u trajtuan në këtë cikël 5-javor biseda fetaro-psikologjike të ndryshme.

Ky cikël i veçantë u përmbyll me sukses, ku u diskutuan dhe mësuan me mjaft vlerë problematikat që has shoqëria shqiptare në përditshmërinë

e saj, si rastet e paragjykimeve ndaj Islamit dhe myslimanëve, sidomos ndaj mbulesës së femrës, pengesat që hasen

në jetën e përditshme, disa të vërteta rreth krijimit, lirinë në veprime, rreth ndërgjegjes së njeriut si dhe natyrën e jashtme dhe të brendshme të shpirtit të njeriut.

Pjesëmarrëset me profesionalizmin dhe njohuritë e tyre u dhanë jetë këtyre takimeve, të cilat ishin tepër të dobishme dhe me interes.

Myftinia Shkodër do të organizojë edhe në të ardhmen me të gjitha kapacitetet e saja, programe dhe cikle të tilla fetare dhe edukuese për të gjitha moshat me qëllim për të përmbushur misionin e saj fisnik në shërbim të së mirës së shoqërisë në përgjithësi.

MEDRESEJA "MEHMED FATIH", MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI RRETH SFIDAVE TË RINISË

Mbrëmjen e së martës, më 25 tetor 2022, me ftesë të Medresesë "Mehmed Fatih" dhe drejtorit të saj, Amer Šukurica, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, ishte i ftuar si ligjërues në medresenë e Tuzit, në Mal të Zi.

Në kuadër të projektit: "Dituria është dritë", Myftiu Sytari, ligjëroi rreth sfidave, me të cilat përballet sot, rinia islame.

Gjatë këtij aktiviteti, Myftiu vizitoi ambientet e medresesë "Mehmed Fatih", sikurse ndau mendime dhe ide të vyera me drejtorin Šukurica dhe stafin e tij, duke theksuar se shqiptarët, gjithandej, kanë ditur ndër shekuj të ndërtojnë vlera dhe të rrezatojnë mirësitë e fesë islame, nga pikënisja e së cilës, përhapën dritën e harmonisë, dinjitetit dhe dijes, plot krenari e dinjitet!

Ai falënderoi kontributin e madh të krejt atyre të nderuarve, që angazhohen sot, për të mbajtur të pashuar këtë dritë dhe për ta transmetuar me besnikëri e urtësi edhe tek brezi i ri i fëmijëve të shqiptarëve në Mal të Zi.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i Shkodrës dhuroi një pjesë të botimeve të tij, për librotekën e pasur të Medresesë "Mehmed Fatih" në Tuz të Malit të Zi.

MYFTIU I SHKODRËS:
"MEDRESEJA E JONË, KRENARI DHE BURIM FRYMËZIMI!"

Paraditën e së mërkurës, më 26 tetor 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në ambientet e Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", ku u prit nga drejtori, z. Kujtim Dervishi.

Gjatë vizitës, Myftiu e përgëzoi drejtorin e Medresesë për fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor 2022-2023, sikurse shprehu vlerësimin e përsëritur për arritjet e medresesë dhe atë që ajo përfaqëson.

Myftiu e lajmëroi drejtorin Dervishi edhe për lajmin e mirë të certifikimit të plotë të vakëfit të Myftinisë Shkodër, kompleksit të Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", pas shumë përpjekjesh legjitime.

Gjatë këtij takimi, Myftiu foli edhe për mbresat e vizitës së një dite më parë në Medresenë "Mehmed Fatih" në Tuz, sikurse theksoi se është koha që medresetë tona të kenë më shumë bashkëpunime, të binjakëzohen e të shohin rrugët e këmbimit të përvojave.

MYFTIU I SHKODRËS, VIZITË PUNE NË "QATAR CHARITY"

Ditën e mërkurë, më 26 tetor 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë pune në "Qatar Charity", ku u prit nga drejtori i saj, z. Mahmoud Shaker.

Në krye të herës, Myftiu vlerësoi kontributet dhe qëndrimet e Shtetit të Katarit, në raport me vendin tonë, besimtarët dhe njerëzit në nevojë, nëpërmjet projekteve të shumta në fusha të ndryshme.

Poashtu, falënderoi z. Shaker për dëshirën e bashkëpunimit dhe dëshmimin e kësaj fryme në takime e aktivitete të ndryshme.

Nga ana e tij, z. Mahmoud Shaker, falënderoi Myftiun e Shkodrës për këtë vizitë me interes të përbashkët, që përkthen më së miri vullnetin e bashkëpunimit dhe interesimin për forcimin e tij, në shërbim të nevojave të komunitetit.

U diskutua për realizimin sa më shpejt të projekteve me interes për Myftininë e Shkodrës, si dhe u shfaq gatishmëria për të ndjekur të gjithë hapat për realizimin e tyre.

"NJERIU DO TË JETË ME ATË QË KA DASHTË NË KËTË BOTË."

O I DËRGUAR I ALLAHUT!

KUR ËSHTË KIAMETI?

- E PYETI NJË SAHABE PEJGAMBERIN (A.S).

I DËRGUARI (A.S) I THA:

"ÇFARË KE PËRGATITUR PËR ATË DITË?"

NJERIU I THA:

ASGJË, PËRVEÇ SE E DUA ALLAHUN DHE TË DËRGUARIN E TIJ!

PEJGAMBERI (A.S) I THA:

"NJERIU DO TË JETË ME ATË QË KA DASHTË NË KËTË BOTË!"

(Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)

MEJTEPI I IM... XHAMIA E FSHATIT DOMËN

Pak histori:

- Xhamia Domën, ndodhet në Njësinë Administrative Postribë, në një zonë malore, përbri malit Maranaj.

- Aktualisht fshati Domën përbëhet prej rreth 50 familjeje myslimane.

- Familjet më të njohura janë: Braqi, Plori, Guri, Kodra, Uruçi, etj.

Xhamia e Vjetër në lagjen Plishtë të Domnit, që daton e ndërtuar në vitin 1786 me kontributin e banorëve të fshatit dhe të Myftinisë Shkodër të asaj kohe, pas rihapjes së besimit në 1990 u mor nga besimtarët e fshatit dhe nën kujdesin e Adem Braqit, me shpenzimet e tyre, u riparua dhe u kthye në gjendjen e mëparshme. Me fillimin e aktivitetit fetar u emërua si imam Adem Braqi.

- Ndërsa, xhamia e re e Domnit është ndërtuar në vitin 2014, në një vakëf të ri, me kontributin e donatorëve kuvajtian dhe ndërmjetësimin e fondacionit "Mirësia".

- Imamët dhe mësuesit e mejtepeve që kanë shërbyer në këtë xhami pas hapjes së xhamisë së vjetër dhe asaj ekzistuese të re e në vazhdim janë: Adem Braqi, Jetmir Braqi, Nexhmi Guri, Agim Braqi dhe imami aktual Smajl Braqi.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 16 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002-2022 është rreth 280 nxënës dhe nxënëse.

Takimi me nxënësit:

Në vazhdën të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi më 21 tetor 2022 një takim me nxënësit e kursit fetar në xhaminë Domën.

Teologu Halluni, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën, që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin, që ato mbartin në përçimin te brezi i ri i mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet ta karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit Fuqiplotë.

Në fund të takimit, në kuadër të muajit të Mevludit Sherif, fëmijët e mejtepit u qerasen me asortimente të ndryshme embëlsirash nga Myftinia Shkodër.

Drejtuesi i arsimit falënderoi imamin dhe mësuesin e mejtepit, z. Smajl Braqi, i cili prej 20 viteve shërben me përkushtim të pa ndërprerë në edukimin e brezit të ri më mësimet e vërteta islame dhe sipas traditës fetare dhe kombëtare.



Profeti i fundit i tërë njerëzimit,

MUHAMMEDI (A.S)

570 - 632

Lindja e Begatë e Hz. Pejgamberit (a.s)

8 tetor 2022 / 12 rebiul-evel 1444

“U ndriçue jeta kur leu ai Resul Qiell e tokë m'at sahat u mbush me nur!”

(Nga Mevludi i Hafiz Ali Ulqinakut)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek